

NË EMER TË POPULLIT

P.nr:105/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti per krimet te Renda kruetari i trupit gjyques **Radoslav Markovic** me sekretaren juridike **Biljana Jovanovic**, ne qeshtjen penale kunder te pandehurit, [REDACTED], per shkak te vepres penale; Keqperdorimi i drejtë se votimit, nga neni 216 par 1 dhe 2 KPRK-es, sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Mitrovicë, PP.nr.128/14 prej dt. 21.08.2017, e perfaqesuar nga prokurori i shtetit nga Mitrovica Ismet Ujkani. Pas mbajtjes se seances fillestare dhe publike prej dt. 26.04.2018 mori kete:

A K T G J Y K I M

I Pandehuri; [REDACTED] nga i ati [REDACTED] e ema [REDACTED], e vajzerise [REDACTED], i lindur me 11.07.1990 ne Skenderaj, kurse me vendbanim ne fsh. Buroje Komuna e Skenderajt, me numer personal [REDACTED] shqiptare, shtetas i Republikës se Kosovës, laborant, ka te kryer shkollen e mesme teknike-kimi, i punesuar ne Autoshkollen "Geci" Skenderaj, i martuar baba i 4 femijve, ndaj tij nuk zhvillohet procedure tjeter per veper penale.

ESHTE FAJTOR

SEPSE:

Me datën 03.11.2013, ne shkollen fillore "Abedin Rexha" ne fsh. Kopiliq i ulte-Skenderaj, ne zgjedhjet lokale ne numrin e vendvotimit nr. [REDACTED], ka votuar një here si votues me kushte, dhe po ne te njejten shkolle fillore "Abedin Rexha" ne fsh. Buroje -Skenderaj, me numrin e vendvotimit [REDACTED] ka votuar si votues i rregullt,

-Me ketë ka kryer veprën penale; Keqperdorimi i te drejtë se votimit nga neni 216 par. 1 pika 1 dhe 2 te KPRK-ës.

-Prandaj gjykata ne mbeshtetje te nenit 4,7,9,10,21,49,50,51,52,73,216 te KPRK-es dhe neni 39 te Ligjit per Kompenzimin e Viktimate, nga neni 248 par 1 ne lidhje me par. 4, dhe neni 365, 366 e 450 te KPP-es , e shqipone kete:

DENIM ME KUSHT

- I. Ku i caktohet denimi me burgim ne kohe zgjatje prej 6-(gjashte) muaj, denimi i shqiptuar nuk do te ekzekutohet nese personi i denuar-i pandehuri brenda periudhes kohore prej 1 vit (njevit) nga plotefuqishmeria e aktgjykimit nuk kryen ndonje veper tjeter penale, te natyres se njejte apo te natyres me te rende, ne te kunderten ky denim do te ekzekutohet .
- II. Obligohet i pandehuri qe ne emer te paushallit gjyqesore te paguaj shumen prej 20.Euro ne afate prej 15.ditesh, nga dita kur aktgjykimi te merr formen e prere.

- III. Obligohet i pandehuri qe ne emer te Programit per Mbrojtjen e Viktimave te Krimtit te paguaj shumen prej 50.euro, ne afate prej 15 ditesh nga dita kur aktkgjykimi te marr formen e prere.
- IV. Kerkese pasuroro juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Komisioni Qendrore i Zgjedhjeve ne Republiken e Kosoves, ka ushtruar kallezimin penal te dt. 25.05.2014, kunder te pandehurit: [REDACTED] me dyshimin per kryerjen e vepres penale; Keqperdorimi i te Drejtes se Votimit nga neni 216 par 1 pika 1 dhe 2 te KPRK-es.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, i ka paraqitur Gjykates Themelore ne Mitrovice-Departamentit per Krime te Renda, aktakuzen PP.nr.128/14 nga data 21.08.2017 ndaj te pandehurit [REDACTED], per shkak te vepres penale : Keqperdorimi i te Drejtes se Votimit nga neni 216 par 1 pika 1 dhe 2 te KPRK-es.

Gjykata Themelore ne Mitrovice, ne kuader te kompetences lendorë, ka caktuar dhe ka mbajtur seancen e shqyrtimit fillestare me dt. 26.04.2018, ne te cilën kane qene te pranishem prokurori i shtetit ne PTH-es, Mitrovice, Ismet Ujkani i pandehuri [REDACTED] dhe perkthyesi i gjykates Enis Krama.

I pandehuri [REDACTED] ne shqyrtimin fillestare ne Gjykaten Themelore ne Mitrovice, pas leximit te aktakuzes PP.nr.128/2014 nga ana e prokurorit te shtetit te P.TH-es ne Mitrovice, e ka pranuar ne tersi fajesine per vepren penale per te cilën eshte i akuzuar – Keqperdorimi i te drejtes se votimit nga neni 216 par 1 pika 1.2 te KPRK-es.

Gjykata e ka shqyrtuar pranimin e fajesise te pandehurit [REDACTED] i cili e ka pranuar fajesine e ne mbeshtetje te nenit 248 KPP-es, ne kete drejtim ka vleresuar se jane permbushur kushtet ligjore per pranimin e fajesise. Gjykata ka vertetuar se pranimi i fajesise nga ana e te pandehurit [REDACTED] eshte ne perputhje me deshmit ekzistuese: Lista e votuesve te rregullt-faqe 34/45 nga e cila shihet se ai ka votuar ne shkollen fillore "Abedin Rexha" ne fsh. Buroje – Skenderaj, si një votues i rregullt ne vendbanimin me nr. [REDACTED] lista e votuesve me kushte, faqe 1/15 ne shkollen fillore "Abedin Rexha" ne fsh. Kopiliq i Ulte-Skenderaj, si një votues me kushte me nr. 0006 e cila konfirmohet ne perputhje me rezultatet e raportit nga Agjensia per Forenzik, AKF/2017-2179/2017-1955 te dt. 18.07.2017 ku ekziston konstatimi dhe mendimi perfundimtar dhe eshte vertetuar fakti se nenshkrimet jane nenshkruar nga personi i njejte. Provat e cekura si me larte dhe pranimi i fajesise i deklaruar nga i pandehuri e bindi gjykaten se i pandehuri e kishte kryer vepren penale: Keqperdorimi i te Drejtes se Votimit nga neni 216 par 1 pika 1 dhe 2 te KPRK-es.

Gjykata ka vertetuar se pranimi i fajesise nga ana e [REDACTED] eshte bere ne menyre vullnetare, i pandehuri e ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesise, dhe duke iu terhequr verejtja te pandehurit se pas pranimit te fajesise ai nuk mund te paraqes ankeset per shkak te konstatimit te gabuar te gjendjes faktike. Gjykata ka vertetuar se aktakuza nuk permban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, nga keto arsyet gjykata ka pranuar pranimin e fajesise te deklaruar nga i pandehuri.

Gjykata nga pranimi i fajesise dhe nga provat e larte cekura, qe i pandehuri Gezim Thaqi e ka kryer vepren penale: Keqperdorimi i te Drejtes se Votimit nga nen 216 par 1 pika 1 dhe 2 te KPRK-es.

Gjykata duke vendosur percaktimin e denimit per kete veper penale ka marr parasysh rrethanat te cilat mund te ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit ne mbeshtetje te nenit 73 te KPRK-es. Si rrethan renduse gjykata ka vleruar dashjen e te pandehurit te kjo veper penale, shkallen e pergjegjesise penale te tij, kontributin esencial ne kete veper penale, faktin se kjo natyre e veprave penale kane qene shume te shprehura ne Kosove, faktin se keto vepra penale kane ndikim negativ tek qytetaret e Kosoves, krijojne mos besimin ne Institucionet e Shtetit, sepse si qe dihet permes rezultatit te votave zgjedhen perfaquesuesit e Institucioneve te Kosoves.

Andaj si rrethane lehtesuese, gjykata ka vleruar, se i pandehuri ka pranuar fajesine ne tersi, faktin se i njejtia ka shprehur keqardhje duke premtuar se ne te ardhmen nuk do te perserise kete veper penale, sjellja e te pandehurit ne gjykate ne raporte me gjykaten dhe palet, fakti se ndaj tij nuk zhvillohet ndonje procedure tjeter te vepres penale, dhe faktin se i pandehuri eshte mbajtes i vetem i familjes. Gjykata ka vertetuar se i pandehuri e kishte kryer kete veper penale, mirepo kjo gjykate ka vertetuar se tek kjo veper penale kane munguar pasojat, sepse nga kallezimi penal i paraqitur ndaj te pandehurit nga Komisioni Qendror i Zgjidhjeve ne Kosove, vertetohet se vota me kushte e te pandehurit [REDACTED], eshte anuluar dhe nuk eshte numeruar, cka nenkupton se vota e tij me kushte nuk ka pasqyruar rezultatin e zgjedhjeve ne Kosove.

Gjykata ne veprimet e te pandehurit nuk ka gjetur ndonje rrethan posaquerisht renduese.

Gjykata vlereson se nje denim i tille i shqiptuar ndaj te pandehurit eshte adekuat dhe gjykata eshte e bindur se me kete denim do te arrihet qellimi i denimit i cili parashihet me ligj.

Lidhur me shpenzimet e procedures gjykata vendimin e mori ne baze te nenit 450 te KPP-es, dhe per kompenzin e Viktimave te Krimtit, duke u bazuar ne nenin 39 te Ligjit per Kompenzin e Viktimave te Krimtit.

Gjykata nga arsyerat e cekura si me larte e bazuar ne nenin 365 te KPP-es, ka vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Departamenti Per Krime Te Renda

P.nr.105/2017, dt.26.04.2018

Sekretarja juridike:

Biljana Jovanovic

Kruetari i trupit gjykues:

Radoslav Markovic

KESHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne Gjykatën e Apelit ne Prishtinë, në afat prej 15(pesëmbodhjet) ditësh nga data e pranimit te aktgjykimit. Ankesa me kopje te mjaftushme i drejtohet Gjykates Themelore.

Përkthyesja:
Sllavica Krasiq
bjçutit

